



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2024:016862  
Datë: 18.01.2024  
Numri i dokumentit: 05208649

**PPP.nr.1/24**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ** - gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në kërkesën e të autorizuarit të kreditorit N.SH “E.I.”, me seli në Lipjan, të cilën e përfaqëson me autorizim av Marigona Gashi nga Lipjani, për përjashtimin e Përmbaruesit Privat B.A. nga Ferizaj, më datë 18.01.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PRANOHET** kërkesa e të autorizuarit të kreditorit N.SH “E.I.”, e ushtruar me datë 16.01.2024, me të cilën ka kërkuar përjashtimin e Përmbaruesit Privat B.A. nga Ferizaj, nga zgjidhja e lëndës P.nr.191/21 dhe përjashtohet Përmbaruesi Privat B.A. nga zgjidhja e lëndës përmbarimore P.nr.191/21.

**A r s y e t i m**

I autorizuari i kreditorit N.SH “E.I.”, me datë 16.01.2024, në këtë gjykatë ka dorëzuar kërkesën me shkrim, me të cilën ka kërkuar përjashtimin e Përmbaruesit Privat B.A. nga Ferizaj, nga zgjidhja dhe procedimi i lëndës përmbarimore P.nr.191/21, me arsyetimin se në rastin konkret përmbaruesi privat nuk ka vepruar siç duhet me urgjencë në çështjen përmbarimore të kreditorit dhe me mosveprimin e tij përmbaruesi privat ka cenuar besimin e kreditorit tek përmbaruesi privat B.A. dhe kreditori dyshon në neutralitetin e përmbaruesit privat.

Përmbaruesi Privat B.A., lidhur me kërkesën e kreditorit për përjashtim, ka dhënë deklaratë me shkrim, ku në deklaratën e dhënë me shkrim është shprehur se me qëllim që të hiqen mëdyshjet dhe rezervat në aspektin subjektiv të vendosjes së kësaj çështje përmbarimore parimisht nuk e kundërshtoj kërkesën për përjashtim, kjo për çështje etike dhe profesionale.

Gjyqtari individual, duke vepruar sipas nenit 17 dhe 325, par 1 dhe 2, të LPP-së, lidhur me nenin 67 dhe 70, të LPK-së, i shqyrtoj shkaqet dhe pretendimet e kreditorit të paraqitura në kërkesën e tij për përjashtimin e përmbaruesit privat B.A. dhe pas analizimit të pretendimeve në kërkesë, vendosi që kërkesën e të autorizuarit të kreditorit N.SH “E.I.”, për përjashtimin e përmbaruesit privat B.A., ta pranoj si të bazuar, nga fakti se nga thëniet e kreditorit në kërkesën për përjashtim dhe nga deklaratat me shkrim e dhënë nga përmbaruesi privat, gjykata ka vërtetuar se kreditori e ka humbur besimin e tij tek veprimet procedurale të përmbaruesit privat në këtë rast dhe konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 67, pika g), të LPK-së, që të përjashtohet përmbaruesi privat B.A. nga lënda përmbarimore P.nr.191/2021, dhe si rrjedhojë vazhdimi i ndërmarrjes së veprimeve tjera përmbarimore në këtë rast nga përmbaruesi privat në lëndën përmbarimore P.nr.191/2021, vetëm do të shkaktonte humbje edhe më të madhe të besimit të kreditorit tek Përmbaruesi Privat.

Andaj, kjo Gjykatë, duke i marr parasysh të cekurat më lart dhe në bazë të nenit 17 dhe 325, par 1 dhe 2, të LPP-së, lidhur me nenin 67, pika g) dhe 70, të LPK-së, e pranoj kërkesën e të autorizuarit të kreditorit dhe e përjashtoj përmbaruesin privat B.A. nga Ferizaj nga zgjidhja e lëndës përmbarimore P.nr.191/2021.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**PPP.nr.1/24, më datë 18.01.2024**

**GJYQTARI**

**Faton Ajvazi**

### **KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi nuk është i lejuar kurrfarë mjeti juridik.